



## EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER COOPERATION PROGRAMME

Çdo subvencion mund ti jepet një aplikanti nga një subjekt që plotëson kushtet e thirrjes publike, dhe nëse ky subjekt zgjidhet atëherë nënshkruan një marrëveshje subvencionimi, dhe më pas mban përgjegjësi për implementimin para donatorit.

### KANDIDATËT QË I PLOTËSOJNË KUSHTET (KANDIDATËT E PËRSHTATSHËM)

Kandidatët e përshtatshëm për marrjen e granteve janë:

- Personi juridik me aktivitet turistik të regjistruar me qendër në Bashkinë e Strugës, R. Maqedonia e Veriut dhe Bashkinë e Pogradecit, R.e Shqipërisë.
- Persona fizikë të regjistruar në regjistrin për kryerjen e aktivitetit turistik në Bashkinë Strugë, R. Maqedonia e Veriut dhe Bashkinë Pogradec, R. Shqipëria.

#### Kriteret për zgjedhje

- Personat juridikë të zgjedhur për subvencionim duhet të jenë veçanërisht të orientuar drejt promovimit të aktiviteteve dhe rezultateve në fushat e mëposhtme:
- Rritja e mundësive për biznes përofruesit lokal të shërbimeve dhe operatorët në fushën e turizmit.

	Kriteret	Vlera	Pikët maksimale
1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Personi juridik</b> me aktivitet turistik të regjistruar me qendër në Bashkinë e Strugës, Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe Bashkinë e Pogradecit, Republika e Shqipërisë. <b>-10</b></li> <li>• ose <b>persona fizikë</b> të regjistruar në regjistrin për kryerjen e aktivitetit turistik në Bashkinë e Strugës, R. Maqedonia e Veriut, dhe Bashkinë e Pogradecit, R. Shqipëria . <b>-20</b></li> </ul>		20
2	<p>Struktura e çatisë - me kushte teknike për vendosjen e paneleve për efikasitetin e tyre (siperfaqja e strukturës së çatisë, sa kohë gjatë ditës është e ekspozuar struktura e çatisë ndaj diellit) minimum 16 metra katrorë.</p> <p><b>Pozita e sipërfaqes së çatisë ( anash ) -10</b></p> <p><b>Sipërfaqja e çatisë (minimum 16 metra katrorë ) -10</b></p> <p><b>Madhësia e objektit -10</b></p>		30



Implemented by



Municipality of Struga



Municipality of Pogradec





EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER COOPERATION PROGRAMME

4	<b>Sipërmarrës ( person fizik ose juridik )</b> <b>Gjinia femërore -10</b> <b>Gjinia mashkullore -5</b>		10
5	<b>Sa është kostoja mesatare vjetore për konsumimin e energjisë</b> <b>&gt;10 000 kw-5</b> <b>&lt;10 000 kw-10</b>		10
7	<b>Lokacioni i objektit –</b> <b>Zonë urbane - 10</b> <b>Zonë rurale- 15</b> <b>Zonë malore - 20</b>		20
8	<b>Benefitet turistitike – Numri i vizitorëve/turistëve gjatë dy viteve të kaluara ( regjistri i turistëve, vizitorë )</b> <b>1000 mysafirë (vizitorë) - 10</b> <b>&lt;1000 mysafirë (vizitorë) - 5</b>		10
	<b>Pikët totale</b>		<b>100</b>

### Procesi i zgjedhjes dhe vlerësimit

Aplikacionet dorëzohen në Bashkine e Strugës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Bashkine e Pogradecit, Republika e Shqipërisë, në gjuhën maqedonase ose shqipe. Zgjedhjen e aplikacioneve e kryen Komisioni i Zgjedhjeve i formuar në nivel të dy bashkive. Në rast të një numri të barabartë të pikëve nga vlerësimi i aplikantëve, për zgjedhjen mund të merren parasysh edhe kriteret për një ndarje të drejtë dhe përfaqësim in mes aplikantëve. Bashkite do të kujdesen që të mos ketë konflikt interesi te ndonjë nga anëtarët e komisionit të zgjedhjeve.

### Organizimi institucional



Implemented by



Municipality of Struga



Municipality of Pogradec





## EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER COOPERATION PROGRAMME

- Kandidatët e zgjedhur do të nënshkruajnë një marrëveshje për subvencion me Bashkinë e Strugës, R. Maqedonia e Veriut dhe Bashkinë e Pogradecit, R. Shqipëria.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, kandidatët e zgjedhur do të kenë detyrimin në fund të vitit aktual të dorëzojnë faturat për konsumin e energjisë elektrike, për të vlerësuar efikasitetin e vendosjes së paneleve.

### Paketa e aplikimit

Dokumentacioni i detyrueshëm për kandidatët duhet të përmbajë të dhënat vijuese:

- Personi juridik me aktivitet turistik të regjistruar me qendër në Bashkinë e Strugës, R. Maqedonia e Veriut dhe Bashkinë e Pogradecit, R. Shqipëria.
- Gjendja aktuale / Certifikata nga regjistri për kryerjen e aktivitetit turistik në Bashkinë e Strugës, R. Maqedonia e Veriut dhe Bashkinë e Pogradecit, R. Shqipëria - e përmbajtur brenda 6 muajve
- Elaborat teknik - kushtet për vendosjen e paneleve (madhësia e strukturës së çatisë, pozicionimi në anën e strukturës së çatisë)
- Listë e pronësisë (kontratë e marrëveshjes për qira të objektit)
- Certifikatë për kategorizimin e objektit (për të gjitha strukturat e akomodimit të shpallura)
- Formulari i plotësuar për aplikacion (i bashkangjitur me link)

### Dorëzimi i paketës së aplikimit

- Të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në Zyren e Protokollit të Bashkisë së Strugës, R. Maqedonia e Veriut dhe Bashkisë së Pogradecit, R. e Shqipërisë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 (nga e hëna deri të premten), me shënim që janë aplikime për subvencionin për projektin "Struga dhe Pogradeci për promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore - COOLTOUR".
- Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **24 Qershor 2024 deri në orën 16:00.**
- Të gjithë kandidatët që do të dorëzojnë aplikimet në lidhje me Thirrjen, do të njoftohen me shkrim për vendimin lidhur me aplikimin e tyre, nëse janë pranuar ose refuzuar. Rezultatet do të publikohen edhe në Web faqen e Bashkisë si dhe Web faqen organizatave partnere të projektit.



Implemented by



Municipality of Struga



Municipality of Pogradec

